

**PROINFINIT SH.P.K**

Pasqyrat Financiare më dhe për periudhën  
nga 13 shtatori 2019 në 31 dhjetor 2019

**PASQYRAT FINANCIARE**

Pasqyra e Pozicionit Financiar

Pasqyra e të ardhurave gjithpërfshirëse

Pasqyra e lëvizjes në kapital

Pasqyra e flukseve monetare

Shenime shpjeguese të pasqyrave financiare

**PROINFINIT SH.P.K**  
**PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR**  
Më 31 dhjetor 2019  
(Vlerat në LEK)

	Shënime	31 dhjetor 2019
<b>AKTIVE</b>		
<b>Aktivët afatgjata</b>		
Aktivët afatgjata materiale dhe jomateriale		-
Parapagimet për aktive		-
<b>Totali i aktiveve afatgjata</b>		<b>-</b>
<b>Aktivët afatshkurtra</b>		
Inventarë		-
Llogari të arkëtueshme tregtare		-
Llogari të arkëtueshme të tjera	4	2,130
Parapagim i tatim fitimit		-
Mjetet monetare në arkë e në bankë	5	240,103
<b>Totali i aktiveve afatshkurtra</b>		<b>242,233</b>
<b>TOTALI I AKTIVEVE</b>		<b>242,233</b>
<b>KAPITALI</b>		
Kapitali themeltar	6	300,000
Fitimi/(humbja) e periudhës		(153,514)
<b>Totali i kapitalit</b>		<b>146,486</b>
<b>DETYRIMET</b>		
<b>Detyrime afatgjata</b>		
Hua afatgjata		-
<b>Totali i detyrimeve afatgjata</b>		<b>-</b>
<b>Detyrime afatshkurtra</b>		
Hua afatshkurtra		-
Llogari të pagueshme tregtare		-
Llogari të pagueshme të tjera	7	95,747
<b>Totali i detyrimeve afatshkurtra</b>		<b>95,747</b>
<b>Totali i detyrimeve</b>		<b>95,747</b>
<b>TOTALI I KAPITALIT DHE DETYRIMEVE</b>		<b>242,233</b>

Pasqyrat Financiare të shoqërisë Proinfinit shpk janë rishikuar nga Asambleja e Ortave dhe janë miratuar më 18 mars 2020.

Ylli Kreci  
 Administrator



**PROINFINIT SH.P.K**  
**PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHPËRFSHIRËSE**  
 Periudha nga 13 shtator 2019 deri më 31 dhjetor 2019  
 (Vlerat në LEK)

	Shënime	Periudha nga 13 shtator 2019 deri më 31 dhjetor 2019
Të ardhurat		-
Kosta e mallrave të shitur		-
<b>Fitimi bruto</b>		<b>-</b>
Shpenzime administrative	<b>8</b>	152,514
Shpenzime financiare neto	<b>9</b>	1,000
Shpenzime të tjera		-
<b>Totali i shpenzimeve</b>		<b>153,514</b>
<b>Fitimi/(humbja) para tatimit</b>		<b>(153,514)</b>
<b>Shpenzimi i tatimit mbi fitimin</b>		
Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin	<b>10</b>	-
<b>Fitimi/(humbja)</b>		<b>(153,514)</b>
<b>Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse (humbje)</b>		<b>(153,514)</b>
<b>Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse (humbje)</b>		<b>(153,514)</b>

*Shënimet shpjeguese nga 1 në 10 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.*

**PROINFINIT SH.P.K**  
**PASQYRA E LËVIZJEVE TË KAPITALIT**  
Periudha nga 13 shtator 2019 deri më 31 dhjetor 2019  
(Vlerat në LEK)

---

	<b>Kapital i paguar</b>	<b>Ftim (Humbje) e akumuluar</b>	<b>Totali</b>
<b>Vlera më 13.09.2019</b>	-		-
Shtesa në kapitalin themeltar	300,000		<b>300,000</b>
Fitimi/(humbja) e periudhës		(153,514)	<b>(153,514)</b>
<b>Vlera më 31.12.2019</b>	<b>300,000</b>	<b>(153,514)</b>	<b>146,486</b>

*Shënimet shpjeguese nga 1 në 10 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.*

**PROINFINIT SH.P.K****PASQYRA E FLUKSIT TË PARASË**

Periudha nga 13 shtator 2019 deri më 31 dhjetor 2019

(Vlerat në LEK)

	Shënime	Periudha nga 13 shtator 2019 deri më 31 dhjetor 2019
<b>Fitimi/(humbja) para tatimit</b>		<b>(153,514)</b>
<b>Axhustime për zërat jo-monetare:</b>		-
Amortizimi		-
Shpenzime për interesa		-
Provizjion për borxhin e keq		-
		<b>(153,514)</b>
<b>Ndryshimi ne kapitalin qarkullues</b>		
Rënie/(rritje) në inventar		-
Rënie/(rritje) në llogari të arkëtueshme dhe të tjera (Rritje)/rënie në të ardhurat e shtyra	<b>4</b>	(2,130)
(Rënie)/rritje në llogari të pagueshme dhe të tjera	<b>7</b>	95,747
<b>Mjetet monetare të gjeneruara nga aktivitetet operative</b>		<b>(59,897)</b>
Interesa të paguara		-
Tatimi mbi fitimin i paguar gjatë vitit		-
<b>Mjetet monetare neto të gjeneruara nga aktivitetet operative</b>		<b>(59,897)</b>
<b>Aktivitetet investuese</b>		
Blerje të aktiveve afatgjata materiale		-
Blerje të aktiveve afatgjata jomateriale		-
Parapagimi per aktive afatgjata		-
<b>Mjete monetare të gjeneruara nga aktiviteti investues</b>		-
<b>Aktivitetet financuese</b>		
Kapital i paguar nga ortakët (Ripagim)/ të hyrat neto nga huatë	<b>6</b>	300,000
Ndryshim në llogari te tjera financuese		-
<b>Mjete monetare të gjeneruara nga aktiviteti financues</b>		<b>300,000</b>
<b>Ndryshimi neto i mjeteve monetare</b>		<b>240,103</b>
Mjetet monetare në fillim të periudhës		-
<b>Mjetet monetare në fund të periudhës</b>	<b>5</b>	<b>240,103</b>

*Shënimet shpjeguese nga 1 në 10 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.*

**PROINFINIT SH.P.K**

**SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE**

Periudha nga 13 shtator 2019 deri më 31 dhjetor 2019

---

(Vlerat në LEK)

**1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM**

PROINFINIT sh.p.k ("Shoqëria") është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuara e themeluar më 13 shtator 2019 me NUIS L92204018G me seli në adresën Njësia Bashkiake Nr. 5, Rr. Tish Daija, Tiranë, Shqipëri.

Shoqëria ushtron aktivitetin e saj në fushën e tregtisë me shumicë të produkteve ushqimore. Më datë 31 dhjetor 2019 shoqëria ka pasur të punësuar vetëm Administratorin e shoqërisë dhe nuk ka kryer aktivitet tregtar.

**2. BAZAT E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE**

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit ("SKK") miratuar nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit dhe shpallur nga Ministria e Financës.

Objekti i pasqyrave financiare të përgatitura sipas Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit është dhënia e informacionit rreth pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të mjeteve monetare të Shoqërisë, të dobishëm për vendimmarrjen ekonomike të një grupi të gjerë përdoruesish të cilët nuk kërkojnë raporte të veçanta për të përmbushur nevojat e tyre specifike për informacion.

Pasqyrat financiare përgatiten mbi bazën e konceptit të materialitetit. Standardet Kombëtare të Kontabilitetit nuk zbatohen për zërat jomaterialë.

Pasqyrat financiare janë përgatitur sipas parimit të vijimësisë, që do të thotë se veprimtaria ekonomike e Shoqërisë do të ketë vijimësi dhe Shoqëria nuk ka në plan ose nuk do ta ketë të nevojshme ta ndërpresë aktivitetin e saj.

**3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE BAZË KONTABËL****3.1. Monedha funksionale dhe raportuese**

Monedha funksionale e Shoqërisë është Leku Shqiptar (LEK), e cila është monedha e përdorur në mjedisin ekonomik në të cilin Shoqëria ushtron veprimtarinë. Shoqëria përgatit dhe raporton pasqyrat e saj financiare në LEK. Transaksionet konvertohen fillimisht duke përdorur kursin e këmbimit midis monedhës së huaj dhe monedhës funksionale në momentin e kryerjes së veprimit që është momenti kur veprimi kualifikohet për njohje në pasqyrat financiare. Në fund të çdo periudhe raportuese, aktivet monetare konvertohen me kursin e fundit të periudhës raportuese. Aktivet jo-monetare mbahen me kosto historike dhe konvertohen në monedhën raportuese me kurset historike të transaksioneve.

Kurset e këmbimit të LEK-ut përkundrejt monedhave të tjera më 31 dhjetor 2019 janë si në vijim:

	<b>31 dhjetor 2019</b>
EUR / LEK	121.77

Për aktivet monetare diferencat që rezultojnë nga konvertimi reflektohen në rezultatin e vitit. Kur diferencat rezultojnë nga zëra jomonetarë ato kalojnë në fitim ose humbje; çfarëdo difference e realizuar nga këmbimet valutore kalon në rezultatin e periudhës. Kur fitimi dhe humbja e zërave jomonetarë njihen në kapitalin neto, edhe diferencat nga këmbimet njihen në kapitalin neto.

**3.2. Inventari**

Inventarët maten me vlerën më të ulët midis kostos së tyre dhe vlerës neto të realizueshme. Kostot e inventarit përfshijnë të gjitha kostot e blerjes dhe të tjera që lindin gjatë procesit të sjelljes së inventarit në gjendjen dhe vendodhjen aktuale. Cdo zbritje tregtare e aplikuar në blerje do të zbritet në përcaktimin e kostos së blerjes së inventarit.

Nëse, për arsye të ndryshme përfshi këtu dëmtimin ose mospërdorimin, vlera neto e rikuperueshme e inventarit bie nën koston e saj, diferenca kalon menjëherë si shpenzim në rezultatin e vitit.

Meqë metoda e vlerësimit me njësi është e papërshtatshme, Shoqëria e vlerëson inventarin e saj nëpërmjet formulës së koston Hyrje e parë – Dalje e parë ("First in First out" ose FIFO).

Më 31 dhjetor 2019 Shoqëria nuk ka pasur inventar pasi në këtë datë nuk ka pas filluar aktivitetin e saj tregtar.



### **3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE BAZË KONTABËL (VAZHDIM)**

#### **3.3. Paraja dhe ekuivalentët e saj**

Paraja dhe ekuivalentë të saj përfshijnë llogari rrjedhëse bankare, para në dorë, depozita me bankat dhe të tjera mjete që janë likuide dhe maturiteti i tyre i mbetur në një datë raportimi nuk është më shumë se 3 muaj.

#### **3.4. Aktive financiare**

Llogari të arkëtueshme dhe të tjera janë aktive financiare që përfaqësojnë një të drejtë kontraktuale për të marrë para në të ardhmen.

Llogari të arkëtueshme, hua dhe kredi të tjera janë aktive financiare jo derivative me interesa fikse ose me pagesa të paracaktuara të cilat nuk janë të kuotuar në tregje financiare dhe janë matur me kosto duke përdorur metodën e interesit efektiv dhe duke i pakësuar për çdo humbje nga rënia në vlerë.

#### **3.5. Detyrime financiare**

Detyrimet financiare përfaqësojnë llogari të pagueshme dhe të tjera, kredi dhe hua të tjera nga institucione financiare dhe të tretët.

Instrumentat financiarë klasifikohen si detyrime financiare në përputhje me substancën e marrëveshjeve kontraktuale dhe përcaktimet e një detyrimi financiar.

Detyrimet financiare (përfshi llogaritë e pagueshme dhe të tjera) maten pas njohjes duke i amortizuar me normën efektive të interesit.

#### **3.6. Aktive afatgjata materiale**

Aktivet afatgjata materiale njihen nëse dhe vetëm nëse është e mundur që Shoqëria në të ardhmen të ketë përfitime ekonomike nga ky aktiv dhe kostot e krijimit të mund të maten. Elementë të tillë si: pjesë këmbimi, pajisje dhe makineri ndihmëse njihen si aktiv afatgjatë material kur plotësojnë kriterin për kapitalizim nga Shoqëria. Në rast të kundërt ato njihen dhe trajtohen si inventarë.

Më 31 dhjetor 2019 Shoqëria nuk ka pasur aktive afatgjata materiale.

### **3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE BAZË KONTABËL (VAZHDIM)**

#### **3.7. Të ardhurat**

Të ardhura konsiderohen hyrjet bruto të përfitimeve ekonomike gjatë periudhës të cilat lindin si pasojë e veprimtarisë dhe aktivitetit normal të Shoqërisë.

Të ardhurat nga shitja e mallrave njihen kur: (i) Shoqëria i ka transferuar blerësit rreziqet dhe përfitime të konsiderueshme në lidhje me pronësinë e mallrave; (ii) Shoqëria nuk mban asnjë të drejtë dhe nuk është e përfshirë në administrimin e mallrave sic ndodh kur ka pronësinë; (iii) vlera e të ardhurave mund të matet; (iv) është e mundur që Shoqëria do të marrë përfitimet ekonomike të lidhura me transaksionin dhe kostot e ndodhura ose që do të ndodhin lidhur me transaksionin mund të maten në mënyrë të besueshme.

E ardhura matet me vlerën e drejtë të përfitimeve të marra ose të arkëtueshme. Vlera e të ardhurave njihet neto nga zbritjet tregtare ose rabatet e marra.

Më 31 dhjetor 2019 Shoqëria nuk ka realizuar të ardhura pasi në atë datë nuk kish filluar aktivitetin e saj tregtar.

#### **3.8. Tatim fitimi**

Më 31 dhjetor 2019 Shoqëria nuk është subjekt për llogaritjen e vlerës së tatim fitimit.

**PROINFINIT SH.P.K****SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE**

Periudha nga 13 shtator 2019 deri më 31 dhjetor 2019

(Vlerat në LEK)

**4. LLOGARI TË ARKËTUESHME TË TJERA**

Më 31 dhjetor 2019 llogari të arkëtueshme të tjera janë si në vijim:

	<b>31 dhjetor 2019</b>
TVSH e rimbursueshme	2,130
Të tjera të arkëtueshme	-
<b>Totali</b>	<b>2,130</b>

**5. MJETE MONETARE NË ARKË DHE BANKË**

Më 31 dhjetor 2019 mjete monetare në arkë dhe bankë janë si në vijim:

	<b>31dhjetor2019</b>
Para në bankë	238,422
Para në arkë	1,681
<b>Totali</b>	<b>240,103</b>

**6. KAPITALI**

Shoqëria është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuara e themeluar më 13 shtator 2019. Kapitali i shoqërisë është tërësisht i paguar dhe më 31 dhjetor 2019 është 300,000 LEK. Kapitali është i ndarë në 3 kuota të ndara si në vijim:

	<b>%</b>	<b>31 dhjetor 2019</b>
Melpomeni Korra	40	120,000
Eda Shuli	40	120,000
Flair Albania shpk	20	60,000
<b>Totali</b>	<b>100</b>	<b>300,000</b>

**PROINFINIT SH.P.K****SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE**

Periudha nga 13 shtator 2019 deri më 31 dhjetor 2019

(Vlerat në LEK)

**7. LLOGARI TË PAGUESHME TË TJERA**

Më 31 dhjetor 2019 llogari të pagueshme të tjera janë si në vijim:

	<b>31 dhjetor 2019</b>
Të pagueshme ndaj personelit	69,264
Sigurime dhe tatim mbi të ardhurat	22,056
Të pagueshme për qira dhe shërbime	4,427
Të tjera të pagueshme	-
<b>Totali</b>	<b>95,747</b>

**8. SHPENZIME ADMINISTRATIVE**

Shpenzime administrative për periudhën nga 13 shtator 2019 deri më 31 dhjetor 2019 janë si në vijim:

	<b>Periudha nga 13 shtator 2019 deri më 31 dhjetor 2019</b>
Paga dhe shpërblime për personelin	69,264
Sigurime shoqërore dhe shëndetsore	22,056
Qira	43,837
Internet, telefoni dhe të ngjashme	1,111
Abonime dhe të ngjashme	8,189
Të tjera administrative	8,057
<b>Totali</b>	<b>152,514</b>

**PROINFINIT SH.P.K****SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE**

Periudha nga 13 shtator 2019 deri më 31 dhjetor 2019

(Vlerat në LEK)

**9. SHPENZIME FINANCIARE NETO**

Shpenzime financiare neto për periudhën nga 13 shtatori 2019 deri më 31 dhjetor 2019 janë si në vijim:

	<b>Periudha nga 13 shtator 2019 deri më 31 dhjetor 2019</b>
Komisione dhe tarifa bankare neto	1,000
Te tjera financiare	-
<b>Totali</b>	<b>1,000</b>

**10. TATIMI MBI FITIMIN**

Më 31 dhjetor 2019 Shoqëria nuk ka realizuar fitim të tatueshëm dhe nuk llogarit shpenzim për tatimin mbi fitimin. Humbja për t'u përdorur për periudhat e ardhshme tatimore më 31 dhjetor 2019 është si në vijim:

	<b>Periudha nga 13 shtator 2019 deri më 31 dhjetor 2019</b>
<b>Fitimi/(humbja) e periudhes</b>	<b>(153,514)</b>
<b>Shpenzime të panjohura:</b>	
Shpenzime pa fatura tatimore	-
Të tjera	-
<b>Total i shpenzimeve të panjohura</b>	<b>-</b>
<b>Fitim i tatueshem (Humbje për t'u përdorur)</b>	<b>(153,514)</b>
<b>Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin</b>	<b>-</b>